

20211492462

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 25 paragrafi 1 dhe 3 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM PËR EMETIM DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 5 DENARË

1. Me këtë vendim përcaktohen karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 5 denarë, të cilat emetohen nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. Monedhat me vlerë nominale 5 denarë janë të punuara nga çeliku i veshur me dy shtresa, ku shtresa e parë është e punuar nga bakri, ndërsa shtresa e dytë nga përzierja e bakrit dhe e zinkut.

3. Monedhat me vlerë nominale 5 denarë kanë diametër 27,50 mm, trashësi 1.80 mm dhe peshë 7,20 gr.

Për çdo monedhë lejohet devijim prej 0,05 mm mbi ose nën diametrin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, 0,08 mm mbi ose nën trashësinë e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe deri 0,40 gr mbi ose nën peshën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Skajet e monedhës janë të sheshtë.

4. Monedhat me vlerë nominale 5 denarë kanë këto karakteristika:

- në pamjen e përparme: në mes me numër është shënuar numri “5”, dhe nën te në hark është shënuar fjala “ДЕНАРИ” (DENARË). Në gjysmën e sipërme të parasë, në hark janë paraqitur gjashtëmbëdhjetë rreze në formë katër-këndorë. Numri “5” shtrihet mbi rrezet.

- në pamjen e pasme: në mes është i gravuar rrëqebulli i cili jeton në pjesën perëndimore të shtetit, dhe përreth saj në formë rrethore është shkruar “РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА” (REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT). Në pjesën e poshtme në hark është shkruar viti i farkëtimit.

5. Monedhat me vlerë nominale 5 denarë të emetuara në pajtim me Vendimin për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të monedhave dhe kartëmonedhave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 25/93), mbeten edhe më tej në qarkullim.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.V. 02-15/IX-4/2021
30 qershor viti 2021
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska